

## VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

### **Vendimi 2019-07K**

**Data: 01.07.2019**

#### **Pajisja me topa Babolat Team për turneun “Peja Open- 2019”**

Kryetari Rexhepi aprovon propozimin e ekipit organizativ të turneut “Peja Open – 2019” për furnizim me topa “Babolat Team” për turneun “Peja Open – 2019”, duke mënjanuar topat Head për shkak të koston më të lartë dhe procedurave doganore.

Topat “Babolat Team” do të porositën në Kompaninë Sporting- Prishtinë.

### **Vendimi 2019-08K**

**Data: 15.07.2019**

#### **Përgaditjet për European Junior Championships 2019**

Pas shqyrtimit të kërkesës së selektorit Arian Ibrahimimi për organizimin e kampit përgatitorë për European Junior Championships, Kryetari Rexhepi merr vendim për mos mbajtjen e përgatitjeve për shkak të vështirësive financiare.

### **Vendimi 2019-09K**

**Data: 21.07.2019**

#### **Blerja e biletave te reja kthyese për ekipin Davis Cup 2019**

Ekipi i “Davis Cup 2019” ka ngatërruar orarin e fluturimit për kthimin e tyre nga Bologna në Tiranë me ç ‘rast federata ka paguar bileta të reja kthyese. Kryetari Rexhepi merr vendim që kostot shtesë të biletave dhe taxit do të ndalen nga rimbursimi / premitë e ekipit.

### **Vendimi 2019-28**

**Data: 26.07.2019**

#### **Rishpallja e konkursit “Komisioner i Garave”**

Me shumicë votash miratohet propozimi për ta rishpallur konkursin për pozitën “Komisioner i Garave”, për të rritur numrin e konkurrentëve dhe konkurrencën në mes të kandidatëve.

Konkursi rishpallët me një afat të hapur prej 15 ditësh, për komunitetin e tenisit dhe më gjerë.

### **Vendimi 2019-10K**

**Data: 21.07.2019**

#### **Koordinatori i Kursit për Trajner të Tenisit “Level 1”**

Kursi për trajner të Tenisit “Level 1” do të mbahet nga data 09-20 Shtator 2019, në Pejë, me ç ‘rast merret vendim që Kreshnik Arifi të jetë koordinator i kampit dhe të përkujdeset për të gjitha aktivitetet përgjatë 12 ditëve të kursit.

Kreshnik Arifi do të kompensohet me 400 € neto, për angazhimin e tij përgjatë 12 ditëve.

### **Vendimi 2019-11K**

**Data: 31 Korrik 2019**

#### **Kushtet për referët ndihmës për turneun TE “Peja Open U16 – 2019”**

Turneu Tennis Europe “ Peja Open 2019” për kategorinë U16 parasheh angazhimin e edhe të 2 ndihmës refer për gjatë gjithë turneut.

Kryetari Rexhepi parasheh këto kushte për ndihmës referat që do të angazhohen:

**Mëditje:** €40 në ditë neto, do të mbulohet nga Federata;

**Dreka dhe uji:** do të mbulohet nga organizatori;

**Transporti** Pejë-Brestovik €35 për ndihmësit nga Peja përgjatë gjithë turneut;

**Transport/Hotel:** nëse ndihmësi është jashtë rajonit të Pejës, mbështetet me max €160 (për komplet turneun).

Në rast se 2 apo me shume persona duan te ndajnë ditët e një ndihmësi ([p.sh.](#) njëri 4 ditë e tjetri 5 ditë) atëherë mbulesa për transport/hotel bëhet në proporcion me ditët e angazhimit.



**Vendimi 2019-12K**

**Data: 31.07.2019**

**Zbritja e çmimit për pjesëmarrje në kursin “Level 1”**

Ndryshohet çmimi për pjesëmarrjen e kandidatëve për kursin për trajner të tenisit “Level 1”, nga shuma €100 për djem dhe €50 për vajza në €65 për djem dhe €35 për vajza.

Kandidatët të cilët tashmë kanë përfunduar në total koston e pjesëmarrjes në kurs do të i’u kthehet diferenca e pagesës.